



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pratimet e Komiteteve të Komiteteve të Vitinës			
02-02-2026			
Procedurë	Numri i	Shprehje	Vlera
07-110	105	153	



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, pika d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 18 të Ligji Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, dhe neni 6 të Rregullores Nr.0203-1334, e datës 18.12.2012 Rregullores për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar, neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.01.2026, miraton këtë:

VENDIM

për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Vitisë për bashkëpunim ndërkombëtar me Komunën e Saint Julien en Genevois - Francë

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për AUTORIZIMIN e kryetarit të Komunës së Vitisë, për të filluar bashkëpunimin ndërkombëtar të qëndrueshëm ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë.

Neni 2

Pas marrjes së autorizimit Kryetari i Komunës së Vitisë e njofton Kryetarin e Komunës së Saint Julien en Genevois për nismën me të cilin kërkohet themelimin i bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 10, pika 6 të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI

Bekim Azizi

